

Zhvillohet workshop-i mbi Krimet Mjedisore organizuar nga Agjencia Evropiane e Hapësirës

Në datat 11-12 qershor 2024, u zhvillua në format hibrid, workshopi i Agjencisë Evropiane të Hapësirës dhe Qendrës së Përbashkët të Kërkimit të Komisionit Evropian mbi Krimet Mjedisore.

Në këtë aktivitet, nëpërmjet Grupit të Punës së EUROSAT-t mbi Auditimet e Mjedisit (EUROSAT/WGEA) ku KLSH anëtarëson, u ftuan të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit, anëtare të këtij Grupi Pune.

Në fokus të takimit dy ditor ishte mbështetja ndaj risive teknologjike dhe monitoruese dhe në mënyrë të veçantë, rritja e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara, në parandalimin dhe reduktimin e krimeve mjedisore.



Një sërë prezantimesh u paraqitën nga të pranishmit, duke u përqëndruar në veprimtaritë konkrete, përafrimin e axhendave të palëve për të ndërtuar strategji kundër krimeve të tilla, të bazuara në prova, si dhe fushatave të ndryshme të ndërmarra nga disa shtete, në lidhje me krimet mjedisore. Vëmendje ju kushtua edhe zbulimit të krimeve mjedisore dhe pasojave që sjellin, identifikimit të problematikave, etj. Pyetjet e shtruarra ishin të orientuara drejt praktikave më të mira të përdorura nga shtetet pjesëmarrëse mbi monitorimin e këtyre krimeve.

Shembuj u sollën gjithashtu nga monitorimi “smart” i pyjeve, si një program që mundëson kontrollin përmes sensorëve në distancë nga platformat satelitore.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit aktiviteti u ndoq online, nga audituesit e Departamentit të Performancës, z. Klarenc Xhaferaj dhe znj. Shqipe Hoxhaj,